



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 78 DATË 24/12/2021

**MBI MIRATIMIN E DHËNIES SË TITULLIT TË LARTË VENDOR
“QYTETAR NDERI” I BASHKISË DIMAL:Z.MIHAL LILI KRIMÇE,
Z.AHMET DERVISH VELÇANI, Z.ISMAIL SELFO LILA, Z.ZOI NDRIO STRORI**

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e tij të datës 24/12/2021, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Sektori i Arsim Kulturës dhe Sporteve pranë Bashkisë Dimal, bazuar në propozimin e Organizatës së Veteranëve Ura Vajguore, Grup Intelektualësh, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 25, Neni 54 gërma “m”, Neni 55, Ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore”, neni 15 pika 1 gërma “a”, neni 16 pika 1, neni 18, VKM Nr 861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregulloreve të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI

Me 13vota PRO nga 13 Këshilltarë prezentë:

1. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Dimal **Z.Mihal Lili Krimçe** me motivacionin:
“Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit si:mësues,drejtues,organizator, specialist, dhe analist me vlera të larta shkencore. Për merita të veçanta në fushën e krijimtarisë me mbi 40 (dyzetë) libra të shkruar prej tij, në të cilat pasqyrohen realisht traditat, zakonet dhe trashëgimia kulturore për zonën e me gjerë”.
2. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor pas vdekjes “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal **Z.Ahmet Dervish Velçani** me motivacionin:
“Për kontributin e dhënë si drejtues i shoqatës atdhetare e kulturore “Shpiragu” dhe organizator me aftësi të veçanta, në njohjen e pasqyrimin me vërtetësi të traditave dhe zakoneve të krahinës së Shpiragut, e zonës së “Mesit të Urave”, si dhe për mbështetjen e fuqishme që u ka dhënë vlerave të LANÇ-it të popullit shqiptar”.
3. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal **Z.Ismail Selfo Lila** me motivacionin:
“Për kontributin e dhënë në fushën e mësimdhënies e metodave shkencore pedagogjike. Për vlerat e larta morale dhe aftësitë e veçanta që manifestoi gjatë viteve të punës në marrëdhënie me nxënësit, mësuesit dhe prindërit”.
4. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal **Z.Zoi Ndrilo Strori**, me motivacionin:
“Për vlerat dhe meritat e veçanta si organizator e drejtues me arritje, në përgatitjen e brezave me dije bashkëkohore, si njohës, mbrojtës e krijues i vlerave historike për komunitetin e Bashkisë Dimal”.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Arsimit Kulturës dhe Sporteve .
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha



